



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 1.8.2023

Nr: 721

Ora: 15:00

VENDIM

PËR

**SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE TË ZAZ-SË NR. 43 TË
ANGAZHUARA NË ZGJEDHJET E PËRSËRITURA PËR KRYETARIN E BASHKISË RROGOZHINË TË
DATËS 23 KORRIK 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 29, pika 3, dhe nenit 161 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOS:

1. Të shpërblejë anëtarët e komisioneve zgjedhore të Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve nr. 43, të angazhuara në zgjedhjet e përsëritura për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë të datës 23 Korrik 2023, si më poshtë:
 - a) Kryetari dhe zv.kryetari i KZAZ-së në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
 - b) Sekretari i KZAZ-së në masën 47.500 (dyzetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë.
 - c) Anëtari i KZAZ-së në masën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
 - ç) Kryetari i KQV-së në masën 4.000 (katër mijë) lekë.
 - d) Anëtari dhe Sekretari i KQV-së në masën 3.500 (tre mijë e pesëqind) lekë.
 - dh) Anëtari i GNV-së në masën 6.000 (gjashtë mijë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 1.8.2023 Nr: 721
Ora: 15:00



“Për shpërblimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore të ZAZ-së nr. 43 të angazhuara në zgjedhjet e përsëritura për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë të datës 23 Korrik 2023”

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 1.8.2023 Nr: 721
Ora: 15:00



“Për shpërblimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore të ZAZ-së nr. 43 të angazhuara në zgjedhjet e përsëritura për Kryetarin e Bashkisë Rrogzhiinë të datës 23 Korrik 2023”